



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Njësia e Auditimit të Brendshëm



RAPORT GJASHTËMUJOR I PUNËS
Njësia për Auditim të Brendshëm

Për periudhën Janar - Qershor, 2025

02.07.2025

Raporti i punës së NJAB-së për periudhën Janar-Qershor të vitit 2025

Në periudhën Janar – Qershor, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin vjetor të punës për vitin 2025, i cili plan është i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.

Ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm dhe Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit të Brendshëm.

Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për periudhën: Janar – Qershor të vitit 2025, kemi arritur të kryejm tre auditime.

Drejtoritë e audituara të planifikuara dhe të realizuara për periudhën Janar – Qershor të vitit 2025

1. Auditimi i Brendshëm në Zyrën e Prokurimit.
2. Auditimi i Performancës, subvencionet në drejtorin për Kultur, Rini dhe Sport.
3. Auditimi i Brendshëm në drejtorin për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

Aktivitetet dhe angazhimet e tjera të Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Angazhimet tona kryesisht kanë qenë:

- Vlerësimi i objektivave për auditime, sipas shkallës së rrezikshmërisë, është pregaditur Plani Strategjik i NJAB për vitet 2025 – 2027, dhe Plani Vjetor i Punës së NJAB-së për vitin 2025.
- Është pregaditur raporti i gjashtëmujorit të dytë dhe raporti vjetor i NJAB-së për vitin 2024, i janë dorëzuar Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NjQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komitetit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.
- Verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2024.
- Gjithashtu NJAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e implementimit të rekomandimeve.

Udhëheqësi i NjAB-së

Ruzhdi Kabashi